



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		18/12/ 2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	59963	

R A P O R T

I

Konsultimit Publik

PËR

Draft-Rregulloren për Transparencë Komunale dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë 2025-2028

Dhjetor, 2024

Hyrje

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Drenasit, si dhe Nenin 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratën e Hapur në Komunë, Komuna e Drenasit ka organizuar një konsultim publik për Draft-Rregulloren për Transparencë Komunale dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë 2025-2028.

Njoftimi për qytetarët për organizimin e konsultimit publik është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik. Publikimi i këtij dokumenti për konsultim publik u bë më datë 05.12.2024 dhe ishte i hapur për sugjerime dhe rekomandime deri më datë 08.12.2024.

Konsultimi publik është njoftuar në:

- Ueb-faqen zyrtare të komunës:

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/?cat=30229>

- Facebook-un e komunës:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1071060058158586&set=a.397973495467249>

- Platformën e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php?OpenPage=20&ClosedPage=0>

Ky raport përmbledh detajet dhe rezultatet e këtij procesi, duke përfshirë pjesëmarrësit, temat e diskutuara dhe rekomandimet e dhëna.

Ecuria e Konsultimit Publik

Konsultimi publik u mbajt më **05 dhjetor 2024**, në **Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit**, duke filluar nga ora 11:00. Ky proces u udhëhoq nga **Komisioni Komunal për hartimin e Draft-Rregullores dhe Planit të Veprimit për Transparencë 2025-2028**, me përbërje si më poshtë:

- Bekim Dobra - Kryetar
- Gentiana Qela - Anëtare
- Ruzhdi Lestrani - Anëtar
- Avdyl Mziu - Anëtar
- Arton Hasani - Anëtar
- Vlora Zuqaku-Morina - Anëtare
- Liridona Ajazi-Fejza - Anëtare
- Egzon Qorri - Anëtar (Anëtar i Kuvendit)
- Rina Gashi - Anëtare (Shoqëria Civile)

Hapja e konsultimit u bë nga z. Bekim Dobra, i cili falënderoi të pranishmit dhe prezantoi rëndësinë e këtij procesi, duke theksuar objektivat kryesore të planit:

- Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në administratën komunale.
 - Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrje.
 - Përmirësimi i komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe komunës.
-

Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi

Në konsultim morën pjesë **38 qytetarë**, të cilët ishin të ndarë sipas gjinisë:

- Femra: **24** (63%)
- Meshkuj: **14** (37%)

Çështjet e Diskutuar dhe Rekomandimet

Z. Dobra prezantoi objektivat e Draft-Planit, duke përfshirë:

1. Zbatimin e standardeve për transparencë dhe llogaridhënie.
2. Promovimin e demokracisë së drejtpërdrejtë lokale.
3. Ndërtimin e një administrate komunale të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse.
4. Objektivat e Planit të Veprimit për Transparencë

Pjesëmarrësit u ftuan të kontribuojnë me pyetje dhe rekomandime. Megjithatë, gjatë këtij takimi, nuk pati asnjë diskutim apo pyetje të parashtruar nga të pranishmit.

Përfundimi

Konsultimi publik për Draft-Rregulloren dhe Draft-Planin për Transparencë përfundoi në ora **11:30**. Procesi u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në qeverisjen lokale.

Përpiloi : Avdyl Mziu



18.12.2024